



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 320 Vendimi

Tiranë, më 9.12.2020

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore znj. Orjanda Liçi, më datë 10.12.2020, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**Subjektit të rivlerësimit:** **Z. Gentian Lile, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.**

**BAZA LIGJORE :** **Nenet 179/b dhe “G”, të Kushtetutës; Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Vendimi nr.78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.**

#### I. RETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Lile, ushtron detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Konstatohet se z. Gentian Lile është emëruar në bazë të urdhërit nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2015, “Për emërimin në detyrë”, të kryetarit të gjykatës dhe aktualisht e ushtron ende këtë detyrë.
2. Referuar përcaktimeve të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.
3. Z. Gentian Lile ka paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një kërkesë regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2020, me objekt: dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
4. Në vijim, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2020, Institucioni i Presidentit të Republikës ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit mbi paraqitjen e kërkesës për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së z. Gentian Lile, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2020, ka informuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, mbi vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, z. Gentian Lile, për shkak të dorëheqjes”.

6. Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 3.12.2020, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr.\*\*\* prot., datë 4.12.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka informuar Komisionin se ndaj vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2020, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. Gentian Lile, për shkak të dorëheqjes”, nuk është ushtruar ankim.
7. Për shkak të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Gentian Lile i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

## II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

8. Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:
 

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*2. Subjekti i rivlerësimit, që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.”*
9. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:
 

*“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*

*2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".”*
10. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:
 

*“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”*
11. Me paraqitjen e dosjes, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit Gentian Lile nga shërbimi gjyqësor i ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për mbarimin e këtij funksioni.
12. Komisioni ka pyetur z.Gentian Lile në datën 7 dhjetor 2020, nëse dërrishon të dëgjohet në një seancë dëgjimore, i cili është përgjigjur se nuk dëshiron të dëgjohet.
13. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeht Kushtetuta për dorëheqje. Kjo sjell si pasojë ndërprerjen e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i

Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit “G”, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Lile, si ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë (përfunduar në datën 4.11.2020).
2. Ndalimin e emërimit të z. Gentian Lile, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 9.12.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda Bektashi**

**Kryesuese**

**Valbona Sanxhaktari**

**Relatore**

**Olsi Komici**

**Anëtar**

*Orjanda Liçi*  
*Sekretare gjyqësore*